

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

P. Nr.: 28/2016

31 gusht 2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, me gjyqtarin e EULEX-it, René van Veen, duke vepruar si gjyqtar i vetëm gjykues, dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore të EULEX-it Asja Zujo si procesmbajtëse, në rastin penal P. Nr. 28/2016 kundër:

F. K., emri i babait: _____; emri dhe mbiemri i gjinisë së nënës: _____; i lindur më _____ në _____; nacionaliteti: _____; statusi martesor: _____; profesioni: _____; adresa aktuale: " _____, _____; numri i letërnjoftimit: _____;

dhe

D. V., emri i babait: _____; emri dhe mbiemri i gjinisë së nënës: _____; i lindur më _____; nacionaliteti: _____; statusi martesor: _____; profesioni: _____; adresa aktuale: adresa e panjohur në _____; numri i letërnjoftimit: _____;

Të dy të akuzuar për veprën penale të:

"Pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare në kundërshtim me nenin 394 paragrafët 1.7 dhe 5, në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës"

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit kryesor, të gjitha të hapura për publikun, më 24, 25, dhe 26 gusht 2016 në praninë e prokurorit të shtetit dhe të akuzuarve F. K. dhe D. V., ku të dytë kanë zgjedhur të përfaqësojnë veten e tyre në këtë procedurë gjyqësore;

Pasi prokurori ka njoftuar për tërheqjen nga ndjekja penale kundër të akuzuarve F. K. dhe D. V. në bazë të nenit 52 të KPP-së, në seancën gjyqësore më 31 gusht 2016;

Në bazë të nenit 363, nënparagrafi (1.1) dhe nenit 366, paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPP) më 31 gusht 2016 në seancë të hapur dhe në praninë e të akuzuarve F. K., D. V., dhe prokurorit të shtetit;

lëshon si më poshtë:

AKTGJYKIM

I.

REFUZOHEt akuza *Pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare kundër të pandehurve F. K. dhe D. V..*

II.

Në bazë të nenit 454, paragrafit (1) të KPP-së, shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore.

ARSYETIM

A. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 mars 2014, Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka nxjerrë një aktvendim për zgjerimin e hetimeve, të datës 24 mars 2014, në rastin e PP 157/2013 (RPP. 70/2013). Zgjerimi kishte të bënte me të dyshuarit (tani të pandehurit) **F. K.** dhe **D. V..** Në këtë aktvendim, është pohuar se ekziston dyshimi i bazuar se të dy të dyshuarit kanë kryer veprën penale në vijim:

“Më 24 mars 2014, hetuesit e TFM-së të EULEX-it (Task Forcës në Mitrovicë) morën informacione nga një burim i besueshëm se dëshmitarët, në rastin e vrasjes së rëndë në tentativë kundër Z. V. _____, duke filluar nga data 25 mars 2014 janë kontaktuar nga dy avokatët e të pandehurit Z. V. _____, D. V. dhe F. K., në mënyrë që t’i udhëzojnë ata lidhur me seancat e ardhshme gjyqësore. Qëllimi i udhëzimeve ishte që të ushtrohej presion mbi dëshmitarët për të ndryshuar deklaratat e tyre, për të gënjyer para trupit gjykues dhe për të dëshmuar në kundërshtim me të vërtetën.

Burimi i ka bërë të ditur zyrtarëve policor të TFM-së se të gjithë dëshmitarët e përkatësisë etnike serbe _____ të cilët kishin për të dëshmuar në gjykatë, ishin kontaktuar gjithashtu nga _____ F.K. dhe D. V.. Ata morën udhëzime në të njëjtën mënyrë, për të ndryshuar të vërtetën dhe për të gënjyer para trupit gjykues, për të siguruar të njëjtin version të fakteve, të favorshëm për të pandehurin, Z. V. _____.”

2. Më 22 mars 2016, Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur aktakuzë (PP 70/13) kundër të pandehurve **F. K.** dhe **D. V..** Të dy të pandehurit janë të akuzuar për veprën penale *“Pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare në kundërshtim me nenin 394 paragrafët 1.7 dhe 5, në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së)”*. Prokurori së bashku me aktakuzën ka dërguar edhe tre dosje kartoni me prova.

3. Kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, në bazë të Ligjit Nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve që ndërlihdën me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës dhe në bazë të nenit 5 (a) të Marrëveshjes ndërmjet Shefit të EULEX-it dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës në aspektet përkatëse të funksionimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarëve të EULEX-it me gjyqtarët që punojnë në gjykatat vendase, të nënshkruar më 18 qershor 2014, më 12 prill 2016 mori vendim GJA.nr. 125/16 duke ia caktuar rastin penal në fjalë P. nr. 28/2016 gjyqtarit të EULEX-it, René van Veen si gjyqtar i vetëm gjykues.
4. Shqyrtimi fillestar u mbajt më 21 prill 2016. Në shqyrtimin fillestar morën pjesë prokurori i EULEX-it z. Pascal Persoons dhe dy të pandehurit e sipërpërmendur. Të dy të pandehurit u deklaruan të pafajshëm. Të pandehurit ishin të informuar në lidhje me dispozitat e nenit 245, paragrafi (6), të KPP-së.
5. Gjatë shqyrtimit fillestar më 21 prill 2016, dy të pandehurit u deklaruan se do të përfaqësojnë veten e tyre në shqyrtimin kryesor.¹ Sipas nenit 57, paragrafi (1), nënparagrafi (1.3) të KPP-së, rasti në fjalë nuk ka të bëjë me mbrojtje të detyrueshme.
6. Më 21 prill 2016, gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues vendosi të mos mbajë një seancë të dytë, por në vend të kësaj ka udhëzuar palët të paraqesin propozimet me shkrim vetëm në pajtim me nenin 245, paragrafi (5), të KPP-së.
7. Të dy të pandehurit ka paraqitur kërkesat për hedhjen e aktakuzës, ndërsa i pandehuri **D. V.** gjithashtu ka paraqitur një kundërshtim ndaj provave, brenda afatit kohor dhe në pajtim me nenin 245, paragrafi (5), neni 249 dhe neni 250 i KPP-së. Prokurori ka paraqitur përgjigje në dy kërkesat me kohë.
8. Më 10 qershor 2016, gjyqtari i vetëm gjykues ka lëshuar dy vendime duke kundërshtuar kërkesën e të pandehurit **F. K.** për hedhjen e aktakuzës dhe kërkesën e të pandehurit **D. V.** për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtim ndaj provave respektivisht. Të dy të pandehurit kanë paraqitur ankesa ndaj vendimit përkatës me kohë.
9. Më 28 korrik 2016, Gjykata e Apelit lëshoi një aktvendim duke hedhur poshtë si të pabaza ankesat e të pandehurve **F. K.** dhe **D. V.**, ndaj vendimit të gjyqtarit të vetëm gjykues të datës 10 qershor 2016
10. Më 9 gusht 2016, gjyqtari i vetëm gjykues lëshoi një urdhër për caktimin e seancave të shqyrtimit gjyqësor për t'u mbajtur më 24, 25, 26 dhe 31 gusht dhe 5 shtator 2016. Shtatë dëshmitarët e propozuar nga prokuroria ishin planifikuar për të dëshmuar në shqyrtimin kryesor. Të gjitha palët dhe dëshmitarët ishin ftuar në mënyrë të rregullt
11. Më 10 gusht 2016, Gjykata Themelore në Mitrovicë ka marrë një njoftim për vdekjen e dëshmitarit E. M. _____, i cili ishte planifikuar të dëshmojë më 26 gusht 2016. Të gjitha palët janë informuar për vdekjen e dëshmitarit me një shkresë të gjykatës të datës 11 gusht 2016
12. Më 17 gusht 2016, prokurori ka paraqitur një propozim për të lexuar deklaratën e dëshmitarit E. M. _____ të regjistruar gjatë fazës hetimore të procedurës të datës 14 gusht 2016. Propozimi u është dorëzuar të pandehurve **F. K.** dhe **D. V.** më 18 gusht 2016

¹ Procesverbali i shqyrtimit fillestar, 21 prill 2016, f. 2.

13. Më 18 gusht 2016, prokuroria ka dorëzuar në gjykatë tre dosjet e kartonit të provave. Në seancën e datës 24 gusht 2016, prokurori sqaroi se dosjet e kartonit përmbanin provat tashmë të zbuluara me aktakuzë me shtimin e dy deklaratave të dëshmitarëve të cilat u zbuluan nga prokuroria më pas.²
14. Shqyrtimi kryesor filloi më 24 gusht 2016 dhe seancat në vijim janë mbajtur më 25, 26 dhe 31 gusht 2016 në praninë e prokurores së EULEX-it, znj Neeta Amin dhe të pandehurit F. K. dhe D. V.. Gjykata dëgjoi pesë dëshmitarë të prokurorisë.
15. Më 31 gusht 2016, në fillim të shqyrtimit kryesor, prokurorja e dha njoftimin e tërheqjes nga ndjekja penale, në përputhje me nenin 52 të KPP-së.
16. Duke pasur parasysh tërheqjen e prokurores nga ndjekja penale, gjyqtari i vetëm gjykues në seancën e datës 31 gusht 2016 ka shpallur aktgjykimin duke refuzuar akuzën, në përputhje me nenin 363, paragrafin (1), nënparagrafi (1.1) të KPP-së.

B. KOMPETENCA E GJYKATËS

17. Sipas nenit 11, paragrafit (1), të Ligjit mbi Gjykatat,³ gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha rastet, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.
18. Neni 9, paragrafi (2), nënparagrafi (2.7) i ligjit të njëjtë thotë se Gjykata Themelore në Mitrovicë, themelohet për territorin e komunës së Mitrovicës jug dhe Mitrovicës veri, Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan, Skenderaj dhe Vushtrri. Sipas aktakuzës së ngritur, vepra e dyshuar penale ka ndodhur në pjesën veriore të Mitrovicës dhe, si rrjedhojë, bie në kuadër të juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, sipas nenit 29, paragrafit (1), të KPP-së.
19. Në bazë të nenit 21, paragrafi (3), dhe nenit 22 të KPP-së, për veprën penale të pengimit të provuarit apo procedurës zyrtare, mbuluar nga neni 394 të KPRK-së, është në kompetencë të Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore. Prandaj, çështja është gjykuar nga një gjyqtari i vetëm gjykues, në përputhje me nenin 25, paragrafi (2), të KPP-së dhe nenin 16, paragrafi (2) të Ligjit të lartpërmendur mbi gjykatat.
20. Kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, në bazë të Ligjit Nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligeve që ndërlidhën me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës dhe në bazë të nenit 5 (a) të Marrëveshjes ndërmjet Shefit të EULEX-it dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës në aspektet përkatëse të funksionimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarëve të EULEX-it me gjyqtarët që punojnë në gjykatat vendase, të nënshkruar më 18 qershor 2014, më 12 prill 2016 mori vendim GJA.nr. 125/16 duke ia caktuar rastin penal në fjalë P. nr. 28/2016 gjyqtarit të EULEX-it, René van Veen si gjyqtar i vetëm gjykues.

C. SHQYRTIMI KRYESOR

² Procesverbal i seancës së shqyrtimit kryesor, 24 gusht 2016, f. 5.

³ Ligji nr. 03/L-199.

21. Seancat e shqyrtimit kryesor janë mbajtur më 24, 25, 26 dhe 31 gusht 2016 në praninë e palëve. Të gjitha seancat kanë qenë të hapura për publikun.
22. Gjatë shqyrtimit kryesor më 24 gusht 2016, i akuzuari F. K. dhe D. V. u deklaruan të pafajshëm për akuzat e ngritura në aktakuzë.
23. Në bazë të nenit 16 të Ligjit mbi kompetencat dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë, gjuha e përdorur në procedurën gjyqësore ishte gjuha angleze. Në përputhje me nenin 1, paragrafi (2), të KPP-së, përkthyesit kanë përkthyer në procedurën gjyqësore dhe të gjitha shkresat gjyqësore relevante për gjykimin nga gjuha angleze në gjuhën serbe dhe anasjelltas⁴. I pandehuri F. K. ishte pajtuar gjatë seancës fillestare që procedura gjyqësore të përkthehet në gjuhën serbe dhe anasjelltas, dhe ai nuk ka ngritur ndonjë kundërshtim lidhur me gjuhën e përdorur gjatë shqyrtimit gjyqësor.

D. PROCEDURA E PARAQITJES SË PROVAVE

D.1. Dëshmitë e dhëna në gjykatë

24. Gjyqtari i vetëm gjykues gjatë shqyrtimit kryesor ka dëgjuar dëshmitë e dëshmitarëve të prokurorisë si në vijim:
1. A. J., më 24 gusht 2016;
 2. B. J., më 25 gusht 2016;
 3. Č. S., më 25 gusht 2016;
 4. D. S., më 25 gusht 2016; dhe
 5. D. V.1, më 25 gusht 2016.

D.2. Deklarata e dëshmitarit të ndjerë E. M. _____

25. Dëshmitari E. M. _____ ishte planifikuar të dëshmojë më 26 gusht 2016. Më 10 gusht 2016, Gjykata Themelore në Mitrovicë ka pranuar një njoftim lidhur me vdekjen e dëshmitarit, dhe të gjitha palët janë informuar në përputhje me rrethanat. Më 17 gusht 2016, prokurori ka paraqitur një propozim për të lexuar deklaratën e dëshmitarit E. M. _____ të regjistruar gjatë fazës së hetimeve të procesit gjyqësor të datës 14 gusht 2016. Propozimi i prokurorisë është diskutuar në seancat gjyqësore më 24 gusht dhe 26 gusht 2016 dhe, me marrëveshjen e dy të pandehurve, gjyqtari i vetëm gjykues ka miratuar propozimin e prokurorit për të konsideruar si të lexuar deklaratën e dhënë nga dëshmitari E. M. _____ në prokurori më 28 prill 2016, në përputhje me nenin 338, paragrafi (1), nënparagrafi (1.1), të KPP-së.⁵

D.3. Dëshmitari i mbrojtur "A"

⁴ Procesverbali i shqyrtimit fillestar, 21 prill 2016, f. 4

⁵ Procesverbali i seancës së shqyrtimit kryesor, 26 gusht 2016, f. 6.

26. Më 24 mars 2014, gjykata ka pranuar një kërkesë nga ana e prokurorisë për masa mbrojtëse në rastin Ppr. 70/2013 duke kërkuar masa mbrojtëse për një dëshmitar të caktuar gjatë fazës së hetimeve të procesit gjyqësor.
27. Më 25 mars 2014, gjyqtari i procedurës paraprake në rastin Ppr. 70/2013 ka lëshuar një urdhër me anë të cilit ka miratuar masat mbrojtëse për dëshmitarin A.
28. Më 22 mars 2016, po të njëjtën ditë është ngritur aktakuza, prokuroria ka parashtruar një kërkesë për urdhërimin e masave mbrojtëse ndaj dëshmitarit A. Në kuadër të aktakuzës, prokuroria po ashtu ka paraqitur një propozim që të lexohet deklarata e dëshmitarit A, e cila ishte dhënë gjatë fazës hetimore të procesit gjyqësor.
29. Më 19 prill 2016, gjyqtari i vetëm gjykues ka lëshuar një urdhër me të cilin ka miratuar masat mbrojtëse ndaj dëshmitarit të mbrojtur A.
30. Më 24 gusht 2016, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, prokurorja e ka njoftuar gjyqtarin e vetëm gjykues, se ajo dëshiron që formalisht të tërheq kërkesën për të lexuar deklaratën e dëshmitarit A, të paraqitur në aktakuzë, për shkak të faktit se dëshmitari ka shprehur gatishmërinë e tij për të dëshmuar në gjykatë të hapur pa masa mbrojtëse.⁶ Gjyqtari i vetëm gjykues ka vendosur që dëshmitari duhet të dëgjohet para se të shfuqizohet urdhri për masa mbrojtëse. Gjukata më pas është njoftuar se dëshmitari nuk do të mund të paraqitet para gjykatës në datën e caktuar për shkak të problemeve shëndetësore dhe si rezultat dëshmia e tij është shtyrë.⁷ Prokuroria është tërhequr formalisht nga akuzat kundër të pandehurve, para se dëshmitari të dëshmonte në gjykatë.

D.4. Provat me shkrim

31. Lidhur me faktin se prokuroria ka paraqitur një parashtrësë për tërheqje nga ndjekja penale para se të dëgjoheshin të gathë dëshmitarët, pranueshmëria e provave me shkrim propozuar nga secila prej palëve nuk është shqyrtuar nga gjyqtari i vetëm gjykues.

E. LIGJI I ZBATUESHËM

32. Vepra e dyshuar penale ka ndodhur në mars 2014.
33. Kodi Penal i Republikës së Kosovës (KPRK), i cili ka hyrë në fuqi më 01 janar 2013,⁸ ishte i zbatueshëm në rastin aktual.
34. Në bazë të nenit 539 të KPP-së, procedura gjyqësore është mbajtur në përputhje me KPP-së, që ka hyrë në fuqi më 01 janar 2013.

⁶Procesverbali i seancës së shqyrtimit kryesor, 24 gusht 2016, f. 8.

⁷Procesverbali i seancës së shqyrtimit kryesor, 31 gusht 2016, f. 2.

⁸ Kodi Nr. 04/L-082.

F. ARSYETIMI LIGJOR

35. Të dy të pandehurit ishin akuzuar se kishin kryer veprën penale të "Pengimit të provuarit dhe procedurës zyrtare në kundërshtim të nenit 394 paragrafët 1.7 dhe 5, lexuar në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës."
36. Në fillim të shqyrtimit kryesor më 31 gusht 2016, prokurorja ka njoftuar për tërheqje nga ndjekja penale, në përputhje me nenin 52 të KPP-së. Më pas prokurorja, ndërsa iu ka referuar nenit 358, paragrafi (2), të KPP-së dhe nenit 358, paragrafi (1), nënparagrafi (1.3), të KPP-së, ka kërkuar nga gjyqtari i vetëm gjykues që të nxjerr një aktvendim me të cilin hidhet poshtë aktakuza.
37. Gjyqtari i vetëm gjykues gjen se, në radhë të parë neni 363 i KPP-së është i zbatueshëm, në vend të nenit 358 të KPP-së. Ekzistojnë dy arsye për një gjë të tillë:
1. Neni 358, paragrafi (2), të KPP-së, përcakton se gjyqtari i vetëm gjykues mund të merr aktvendim më të cilën aktakuza hedhet poshtë "edhe pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor". Në të kundërtën, nuk theksohet se ai/ajo mund të bëjnë një gjë të tillë edhe pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor.
 2. Për më tepër, edhe nëse do të ishte e mundur hedhja poshtë e aktakuzës pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor, njëra nga kushtet e nenit 358, paragrafi (1), të KPP-së do të duhet të përmbushet. Në kundërshtim me argumentin e prokurores, gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se vetë fakti që prokuroria ka heq dorë nga dëgjimi i dëshmitarit të fundit, z. S. V. _____, pavarësisht nga arsyet për një vendim të tillë, nuk është një rrethanë e cila ndalon ndjekjen penale, siç përcaktohet në nenin 358, paragrafi (1), nënparagrafi (1.3), të KPP-së.
38. Për shkak të gjitha këtyre arsyeve, gjyqtari i vetëm gjykues, sipas nenit 363, paragrafit (1), nënparagrafit (1.1), të KPP-së, refuzon akuzën kundër të pandehurve **F. K.** dhe **D. V.**

G. SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE

39. Vendimi mbi shpenzimet, siç përcaktohet në dispozitiv, është marrë në përputhje me nenin 454, paragrafin (1), të KPP-së.

René van Veen
Gjyqtari i vetëm gjykues i
EULEX-it

Asja Zujo
Procesmbajtëse

Këshillë juridike: Personat e autorizuar kanë të drejtë për të paraqitur ankesë kundër këtij aktgjykimi brenda 15 ditëve nga dita e dorëzimit të tij (neni 380, paragrafi (1) të KPP-së).